

**LIGJ**  
**Nr.3349, datë 3.10.1961**

**MBI MBROJTJEN E PYJEVE**

KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

VENDOSI

APROVIMIN E LIGJIT MBI MBROJTJEN E PYJEVE

**KAPITULLI I**  
**FONDI PYJOR**

Neni 1

Të gjithë pyjet dhe tokat pyjore që ndodhen në territorin e Republikës Popullore të Shqipërisë, janë pasuri e të gjithë popullit dhe përbëjnë fondin pyjor të shtetit, i cili mbrohet, administrohet dhe shfrytëzohet sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 2

Pyll, sipas këtij, është çdo sipërfaqe toke më tepër se një dynym, e mbuluar me drurë ose shkurre të çfarëdo moshe ose gjendjeje zhvillimi, e cila ndodhet jashtë kufijve të qyteteve

Neni 3

Janë toka pyjore të gjithë livadhet, kullotat, shkëmbenjt, ranishtet, liqenet, vendet e djegura dhe të zhveshura që ndodhen në pyje.

Në tokat pyjore mund të përfshihen, me vendim të Këshillit të Ministrave, edhe tokat e zhveshura, të gërryera dhe ranishtet, të cilat ndodhen jashtë pyjeve dhe janë të papërshtatshme për t'u mbjellë me kultura bujqësore ose për kullotje, tokat e cekta si dhe tokat e punueshme kur shfaqet nevoja e pyllëzimit të këtyre për të luftuar gërryerjen.

Pyjet që krijohen nga kooperativat bujqësore ose organizatat shoqërore në tokat e tyre, përfshihen në fondin pyjor të shtetit, por u lihen atyre për administrim dhe shfrytëzim të përhershëm dhe pa shpërblim.

Neni 4

Në fondin pyjor të shtetit nuk përfshihen:

a) drurët e veçuar ose grupet e drurëve që ndodhen në mes ose rreth tokave bujqësore kullotave, në qytete, buzë kanaleve ujitëse dhe kullues, vijave të mullinjve me ujë, buzë rrugëve automobilistike, hekurudhore dhe këmbësore;

b) parqet dhe sipërfaqet e pyllëzuara pranë monumenteve dhe varrezave, të cilat ndodhen jashtë kufijve të pyllit, pavarësisht nga sipërfaqja e tyre;

c) brezat pyjorë mbrojtës.

Neni 5

Tokat e punueshme që ndodhen në pyje mund të shpronësohen me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas dispozitave në fuqi për t'u përfshirë në fondin pyjor të shtetit, kur këto toka i

shkaktojnë dëme ekonomisë pyjore, ose janë pengesë për zhvillimin normal të saj.

#### Neni 6

Pyjet dhe tokat e fondit pyjor mund të hiqen nga ky fond me vendim të Këshillit të Ministrave dhe, kur sipërfaqja e tyre është gjer në 5 hektarë, me urdhër të ministrit të bujqësisë, por në çdo rast duke u ruajtur uniteti i fondit pyjor.

#### Neni 7

Sipas rëndësisë së tyre, pyjet ndahen: në pyje për qëllime ekonomike dhe në pyje për qëllime të posaçme.

Pyje për qëllime ekonomike janë ata pyje, të cilët shërbejnë kryesisht për të prodhuar material drusor dhe prodhime të tjera pyjore.

Pyje për qëllime të posaçme janë:

a) pyjet mbrojtës në ranishtet bregdetare, në brigjet ose shtretet e përrrenjve dhe lumenjve, rreth burimev, gjatë brigjeve të rrjedhjes së ujrave dhe të rezervuarëve të ujrave, brezat pyjorë mbrojtës që shtrihen gjatë rrugëve automobilistike ose hekurudhore, grumbuj pyjore që ndodhen në kufirin e sipërm të vegjeticionit pyjor;

b) pyjet që ndodhen rreth vendeve klimaterike;

c) zonat e gjelbërta që ndodhen rreth e rrotull qyteteve të mëdhenj dhe qendrave industriale;

ç) vendet e rezervuara;

d) brezat pyjore shtetërore mbrojtës;

dh) tokat pyjore të gërryera, të pyllëzuara ose jo, kur gërryerja është mjaft e zhvilluar dhe rrezikon qendra të banuara, rrugë automobilistike dhe hekurudhore, ndërtime industriale dhe të bonifikimit etj.

Përcaktimi i pyjeve si pyje për qëllime ekonomike, ose si pyje për qëllime të posaçme bëhet nga Ministria e Bujqësisë, duke u patur parasysh edhe mendimi i ministrive të interesuara.

## KAPITULLI II

### ADMINISTRIMI, TRAJTIMI DHE SHFRYTËZIMI I FONDIT PYJOR

#### Neni 8

Fondo pyjor administrohet nga Ministria e bujqësisë me anën e drejtorisë së përgjithshme të pyjeve, të drejtorive të pyjeve dhe të zyrave të pyjeve (organe pyjore)

Të drejtat dhe detyrat e organeve të sipërme caktohen me dispozita të nxjerra nga Qeveria.

#### Neni 9

Ministria e bujqësisë përcakton, mat dhe shënon në vend, me shenja dalluese, kufijtë e pyjeve dhe të tokave pyjore dhe mban evidencën e fondit pyjor.

#### Neni 10

Pyjet dhe tokat e fondit pyjor, me vendim të Këshillit të Ministrave mund t'u jepen në administrim dhe shfrytëzim ministrive të tjera dhe organizatave kooperativiste ose shoqërore.

Pyjet dhe tokat e fondit pyjor, me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, mund t'u jepen përkohësisht ministrive të tjera, organizatave kooperativiste ose shoqërore për të plotësuar nevojat

e tyre, por pa të drejtë që të shfrytëzojë material drusor dhe prodhime të tjera pyjore.

Ministria e bujqësisë kontrollon administrimin dhe shfrytëzimin e pyjeve që u janë besuar ministrive ose organizatave kooperativiste ose shoqërore.

#### Neni 11

Administrimi dhe shfrytëzimi i pyjeve për qëllime ekonomike bëhet duke u patur parasysh vetitë mbrojtëse të pyllit.

Administrimi i pyjeve për qëllime të posaçme bëhet duke u patur parasysh funksionet e tyre të veçanta.

#### Neni 12

Të gjithë pyjet administrohen, trajtohen dhe organizohen sipas planeve të mbarështrimit. Planet e mbarështrimit hartohen dhe aprovohen nga Ministria e bujqësisë.

#### Neni 13

Mbarështrimi i pyjeve synon në trajtimin e tyre si pyje të lartë dhe në shndërrimin gradual të pyjeve të ulët në pyje të lartë.

Mbajtja e pyjeve të ulët lejohet vetëm kur kjo është e nevojshme për shkak të kushteve biologjike të përbërjes së pyllit, ose për nevojat e popullsisë.

#### Neni 14

Shfrytëzimi i pyjeve të lartë nuk mund të bëhet para se të kenë arritur moshën 60 vjeç, me përjashtim të pyjeve me plep, eukalipt dhe akaçie, kurse shfrytëzimi i pyjeve të ulët, para se të kenë arritur moshën 10 vjeç.

Krasitja e pyjeve për gjetë është e ndaluar dhe mund të lejohet vetëm në raste të veçanta nga Ministria e bujqësisë.

#### Neni 15

Sasia e përgjithshme e shfrytëzimit vjetor të pyjeve në këmbë (fondi vjetor i prerjeve) nuk mund të kalojë shumën e sasive të shfrytëzimit vjetor të çdo ekonomie pyjore të caktuar në planet e mbarështrimit. Megjithatë, në raste të jashtëzakonshme, me vendim të Këshillit të Ministrave, fondit vjetor i prerjeve mund të shtohet, me kusht që sasia e tejkaluar e prerjeve të vihet në vend brenda 10 vjetëve, duke u pakësuar fondit i prerjeve gjatë këtyre vjetëve.

#### Neni 16

Punimet e pyllëzimeve, që bëhen për të luftuar gërryerjen e tokës, dhe ndërtimi i pritave të ndryshme nëpër përrënjt ose në luginat ujëmbledhëse të liqeneve artificiale, bëhen në bazë të projekteve teknike të aprovuar nga Ministria e bujqësisë.

Projektet teknike, që parshikojnë shpërngulje të popullsisë, vihen në zbatim pasi të aprovohen nga Këshilli i Ministrave.

#### Neni 17

Trajtimi dhe shfrytëzimi i pyjeve dhe i tokave pyjore bëhet sipas një plani që synon në shtimin e prodhueshmërisë së tyre, në plotësimin e nevojave të ekonomisë popullore me material

drusor dhe prodhime të tjera pyjore si dhe në rritjen e efektit të vetive mbrojtëse të pyjeve.

Ndalohet kryerja në pyje e veprimeve, të cilat pakësojnë prodhueshmërinë dhe efektin e vetive mbrojtëse të tyre, pengojnë ripërtëritjen e pyjeve, keqësojnë gjendjen e tyre dhe përbëjnë rrezik për shkatërrimin e tyre.

#### Neni 18

Mënyra e trajtimit, radha dhe sasia e shfrytëzimit të pyjeve përcaktohen në planet e mbarështrimit.

Llojet dhe mënyrat e prerjes dhe periudhat e ripërtëritjes së pyjeve caktohen me dispozita të nxjerra nga Ministria e bujqësisë.

#### Neni 19

Në pyjet e lartë prerja lejohet gjatë gjithë vitit, kurse në pyjet e ulët prerja lejohet vetëm nga 1 tetor gjer më 31 mars.

Shkurret me vleftë të pakët priten gjatë gjithë vitit.

Në rast se vegjetacioni vonohet në pyjet e ulët, Ministria e bujqësisë mund të zgjatë periudhën e prerjes gjer më 30 prill.

Për mbrojtjen e filizerisë, në disa grumbuj pyjore të lartë, prerja mund të ndalohet duke filluar nga 1 prill gjer më 1 tetor.

#### Neni 20

Transportimi i materialit drusor nga vendet e prerjes gjer në depot e përkohshme lejohet gjatë gjithë vitit, por për pyjet e lartë gjithmonë jo më tej se gjashtë muaj nga koha e prerjes.

Transportimi i lëndës së ndërtimit prej ahu, që është prerë prej 1 prill gjer më 1 tetor, lejohet jo më tej se dy muaj nga koha e prerjes.

#### Neni 21

Caktimi i sipërfaqeve të pyjeve të lartë për t'u prerë, damkimi i drurëve, matja, llogaritja e sasisë dhe e asortimenteve që dalin nga shfrytëzimi i drurëve në këmbë, bëhet gjer më 30 qershor të vitit paraardhës.

Prerja e tyre fillon vetëm mbsi të jetë marrë leja e prerjes.

#### Neni 22

Durët e pyjeve të lartë që janë caktuar për t'u prerë shënohen me damkë të posacme vetëm nga personeli i organeve pyjore.

Ndalohet prerja e drurëve pa qenë të shënuar me damkë.

#### Neni 23

Drurët priten rrafsh me tokën kur kanë diametër nën 15 cm, dhe kur diametri i tyre kalon të 15 cm, lartësia e cungjeve mbi tokë nuk mund të jetë më shumë se 1/3 e diametrit të tyre.

Pastrimi i pyllit nga mbeturinat bëhet njëkohësisht me shfrytëzimin e tij.

Si mbeturina të materialeve drusore quhen celfat, lëvoret, degët dhe majat që nuk vlejné për t'u përdorur për qëllime industriale ose për dru zjarri.

#### Neni 24

Kanë të drejtë të shfrytëzojnë pyjet:

- a) organet pyjore;
- b) ndërmarrjet shtetërore të shfrytëzimit të pyjeve;
- c) kooperativat bujqësore dhe fshatarët, por vetëm për të plotësuar nevojat e tyre për lëndë ndërtimi dhe dru zjarri.

Lejimi i të tjerëve për të shfrytëzuar pyjet bëhet vetëm me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 25

Shfrytëzimi dhe transportimi i materialit drusor dhe i prodhimeve të tjera pyjore bëhet pasi të jetë lëshuar leja e shfrytëzimit nga organet përkatëse pyjore, kundrejt pagimit të taksës pyjore sipas tarifës së aprovuar nga Këshilli i Ministrave.

Me vendim të Këshillit të Ministrave mund të lejohet shfrytëzimi i materialit drusor pa u paguar taksa.

#### Neni 26

Taksa pyjore e papaguar në afatet e caktuara, nxirret si e ardhur shtetërore sipas dispozitave mbi nxjerrjen e të ardhurave shtetërore.

#### Neni 27

Të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e shfrytëzuesve të materialit drusor dhe të prodhimeve të tjera pyjore si dhe marrëdhëniet e tyre me organet pyjore, përcaktohen me dispozita të nxjerra nga Këshilli i Ministrave.

#### Neni 28

Materiali drusor që nevojitet për të kryer punime të ndryshme në dobi të ekonomisë pyjore dhe të ekonomisë së gjuetisë, mund të pritet jashtë planit vjetor të shfrytëzimeve dhe pa u paguar taksa pyjore.

Materiali drusor që nevojitet për ndërtimin e triangulacionit dhe të shenjave të tjera gjeodetike, për studime gjeologjike, për ndërtimin e urave, të vijave telefonike etj., të prishura nga agjentët atmosferikë, kur këto objekte ndodhen në pyje, jepet jashtë planit vjetor të shfrytëzimeve, por duke u paguar taksa pyjore.

#### Neni 29

Për administrimin dhe shfrytëzimin e pyjeve, të cilët u janë dhënë ministrive të tjera dhe organizatave kooperativiste e shoqërore (neni 10) dhe të pyjeve që krijohen nga kooperativat bujqësore ose organizatat shoqërore në tokat e tyre, (neni 3, paragrafi i fundit), zbatohen dispozitat e këtij ligji.

#### Neni 30

Rukullisja dhe transportimi i materialit drusor në pyje bëhet vetëm me anën e ligjeve, skelave, rrugëve, teleferikëve dhe dekovileve në vende të caktuara nga organet pyjore, në bashkëpunim me shfrytëzuesit.

#### Neni 31

Ndërtimi ose ngritja e depove, banesave, shkollave, barakave, staneve, furrave të gëlqeres, çelja e guroreve etj., në pyje ose jashtë tyre, por në një largësi më të vogël se 100 metra nga pylli, si dhe ndërtimi ose ngritja e stabilimenteve për shfrytëzimin dhe përpunimin e materialit drusor dhe të prodhimeve të tjera pyjore në pyje ose jashtë tyre, por në një largësi më të vogël se një kilometër nga pylli, bëhet me leje të veçantë të organeve pyjore.

#### Neni 32

Ndërtimet e përkohshme si dhe instalimet e ndryshme që ndodhen në pyje, duhet të hiqen brenda një viti, pasi të ketë marrë fund veprimtaria për të cilët qenë ngritur.

Me kalimin e këtij afati ndërtimet dhe instalimet u kalojnë pa shpërblim organeve të pyjeve.

### KAPITULLI III

#### KULLOTJA NË PYJE DHE SHFRYTËZIMI I PRODHIMEVE TË TJERA PYJORE

#### Neni 33

Ndalohet rreptësisht kullotja:

a)në pyjet për qëllime të posaçme (neni 7);

b)në pyllëzimet, në sipërfaqet pyjore, ku drurët janë prerë rrafsh dhe që ripërtërihen në mënyrë natyrale, për dhentë dhe derrat, gjersa fidanet të kenë arritur lartësinë një metër e gjysëm, kurse për bagëtitë e trasha gjersa fidanet të kenë arritur lartësinë tre metra;

c)në grumbuj pyjorë që kanë arritur moshën e pjekurisë, në të cilët pritet që të arrihet ripërtëritja natyrale;

ç)në pyjet e shfrytëzuar ose në shfrytëzim e sipër, gjersa të jetë bërë ripërtëritja natyrale e tyre dhe fidanët të kenë arritur lartësinë e parashikuar nga pika “b” e këtij neni.

Megjithatë, si përjashtim dhe me leje të posaçme, kullotja mund të lejohet kur pyjet janë të lartë, të pa shfrytëzuar dhe pa ripërtëritje.

#### Neni 34

Ndalohet rreptësisht kullotja e dhive në të gjithë pyjet, me përjashtim të pyjeve të degraduar dhe të shkurreve posacërisht të caktuara për kullotje.

#### Neni 35

Sipërfaqet pyjore, në të cilat lejohet kullotja, caktohen çdo vit nga organet pyjore sipas planeve të mbarështrimit dhe gjendjes së pyjeve.

Organet pyjore caktojnë, gjithashtu, numrin e bagëtive që mund të kullotin në pyje, sipas normave që vijojnë:

a)prë çdo kokë dele ose derri, 0.2-0.5 hektarë sipërfaqe pyjore;

b)për çdo kokë bagëti të trashë ose dhi 0.5-1 hektar] sipërfaqe pyjore.

#### Neni 36

Leja për kullotjen e bagëtive në pyje jepet, kundrejt pagimit të taksës përkatëse, nga organet pyjore, të cilët caktojnë në lejen edhe vendet për kullotje,.

Kullotja e bagëtive bëhet vetëm duke qenë këto të shoqëruara nga barinjtë.

#### Neni 37

Organet pyjore caktojnë shtigjet e kalimit të bagëtisë për në kullota, burimet dhe vendet ku ato do të mërzejnë.

Shfrytëzuesit e kullotave detyrohen të bëjnë gardh në të dy anët e shtigjeve të kalimit të bagëtive, kur këto shtigje ndodhen në vende ku kullotja është e ndaluar.

Materiali që nevojitet për bërjen e gardhit jepet pa shpërblim nga organet pyjore.

#### Neni 38

Nxjerrja nga pylli e prodhimeve të tjera pyjore (farëra, fruta, bimë mjekësore, rrëshinë, lëvore gjethe, bar) bëhet me leje të posacme të organeve pyjore, pasi të jetë paguar taksa përkatëe. Prodhimet pyjore, për të cilat nuk kërkohet leje dhe nuk paguhet taksë, caktohen me dispozita të Ministrisë së bujqësisë.

#### Neni 39

Organizimi i apikulturës në pyje bëhet me leje të organeve pyjore pa u paguar taksë.

### KAPITULLI IV PYLLËZIMI DHE LUFTIMI I GËRRYERJES SË TOKËS

#### Neni 40

Pyllëzimet në tokat e fondit pyjor bëhen me qëllim që:

- a) të sigurohet me kohë ripërtëritja e pyjeve në të cilët bëhet shfrytëzimi;
- b) të shndërrohet përbërja dhe të rritet prodhimtaria e pyjeve të ralluar, të degraduar, të atyre me prodhim të ulët dhe krasiten;
- c) të bëhen të vlefshme për prodhime pyjore sipërfaqet e zhveshura malore dhe të përforcohen tokat e gërryera gjatë përrrenjve;
- ç) të gjelbërohen periferitë e qendrave të banuara, qendrave industriale, qendrat klimaterike, rrugët automobilistike, hekurudhore etj.

#### Neni 41

Pyllëzimet në fondin pyjor organizohen dhe bëhen nga organet pyjore sipas planeve të mbarështrimit dhe projekteve teknike të pyllëqimit. Planet dhe projektet e objekteve, në të cilët do të ndërmarren punime bonifikimi nga ministritë ose institucionet e tjera, bashkërendohen me organet pyjore para aprovimit të tyre.

#### Neni 42

Sipërfaqet pyjore të zhveshura, të gërryera dhe të shkreta mund t'u jepen nga ana e Ministrisë së bujqësisë ndërmarrjeve të ndryshme shtetërore ose organizatave shoqërore për pyllëqim.

### KAPITULLI V MBROJTJA E PYJEVE

#### Neni 43

Mbrojtja e pyjeve kryhet nga organet pyjore dhe përfshin:

- a) mbrojtjen e pyjeve nga prerjet dhe kullotjet në to pa leje, si dhe nga dëmtimet e tjera;
- b) mbrojtjen preventive të pyjeve nga zjarri dhe organizimin e luftimit kundër tij;
- c) mbrojtjen e pyjeve nga sëmundjet, insektet dhe dëmtuesit e tjerë.

#### Neni 44

Ndalohet shitja, blerja dhe transportimi i materialit drusor ose i prodhimeve të tjera pyjore të pashoqëruar me lejen përkatëse ose ndonjë dokument tjetër, me anën e të cilave të vërtetohet se janë prodhuar në bazë të dispozitave të këtij ligji.

Shitja e materialit drusor, që është dhënë për plotësimin e nevojave personale, bëhet me lejen e organeve pyjore.

#### Neni 45

Personeli i organeve pyjore si dhe ai i organeve të Policisë popullore kanë të drejtë të kontrollojnë të gjitha dokumentat e prerjes dhe të transportimit të materialit drusor që nxirret jashtë pyjeve, dokumentat e lejimit të kullotjes në pyjet, të gjuetisë dhe peshkimit në ujrat malore dhe të nxjerrjes së prodhimeve të tjera pyjore.

Gjithashtu, ata kanë të drejtë të kontrollojnë të gjitha mjetet e transportit që transportojnë material drusor ose prodhime të tjera drusore.

Drejtnesit e mjeteve të transportit, kur transportojnë material drusor ose prodhime të tjera pyjore, janë të detyruar të ndalojnë në çdo vend e në çdo kohë mjetin, kur kjo u kërkohet nga personeli i organeve pyjore.

#### Neni 46

Ndalohet:

a) ndezja e zjarrit të hapet në pyll ose jashtë tij në një largësi që rrezikon pyllin nga marrja e zjarrit;

b) hedhja në pyje dhe në tokat pyjore me barëra moçalore të thata të cigareve të ndezur;

c) hedhja jashtë e prushit të qymyrit dhe e çdo tjetër mbeturinë nga vatra e zjarrit të lokomotivës, të traktorëve dhe të automjeteve në ato vendpyjore ku kalojnë hekurudhat ose rrugët e tjera;

ç) tymosja e bletëve të pyllit, përveç kur kjo bëhet me mjete që kanë pajisje të posacme dhe me kapak plotësisht të mbyllur;

d) çdo veprim tjetër që, sipas dispozitave të nxjerra nga Ministria e bujqësisë në lidhje me pyjet, konsiderohet se krijon rrezik për pyjet.

#### Neni 47

Prodhimi i qymyrit të drurit bëhet brenda në pyjet me leje të organeve pyjore dhe në vende të caktuara në marrëveshje me frytëzuesit.

#### Neni 48

Farërat pyjore, kalemët, fidanët, materialet drusorë si dhe çdo prodhim tjetër pyjor, kur preken nga sëmundje, insekte të dëmshme dhe barëra të këqia, u nënshtrohen rregullave të vecanta sipas dispozitave përkatëse mbi karantinën bujqësore dhe pyjore.

#### Neni 49

Kur në pyje bie zjarr, banorët e fshatrave që ndodhen në afërsi të vendit të rënies së zjarrit, punonjësit që punojnë në pyje si dhe çdo person tjetër që kalon rastësisht, janë të detyruar të marrin pjesë në shuarjen e tij.

#### Neni 50

Këshillat popullore janë të detyruara të ndihmojnë personelin e organeve pyjore në mbrojtjen e pyjeve dhe në organizimin e luftës kundër zjarrit, sëmundjeve, inskteve dhe dëmtuesve të tjerë të pyjeve.

#### Neni 51

Personeli i organeve pyjore, gjatë kryerjes së detyrave të tij, ka të drejtë të mbajë armë zjarri, pa qenë nevoja të pajiset me leje të vecantë nga organet e Ministrisë së punëve të brendshme. Personeli i organeve pyjore, gjatë kryerjes së detyrave të tij, barazohet me organet e Policisë popullore.

#### Neni 52

Personeli i organeve pyjore, gjatë kryerjes së detyrave të tij, duhet të jetë veshur detyrimisht me uniformën përkatëse, e cila i jepet pa pagesë.

Lloji i uniformës mënyra e mbajtjes së saj etj., përcaktohen me dispozita të vecanta të Qeverisë.

#### Neni 53

Për nevojat e shërbimit pyjor shteti ndërton banesa të posacme (stacione pyjore) të cilat i jepen për banim dhe pa pagesë personelit të organeve pyjore.

Personeli i organeve pyjore ka të drejtë të nxjerrë material drusor dhe prodhime të tjera pyjore për nevojat e tij, sipas dispozitave të nxjerra nga Ministria e bujqësisë.

### KAPITULLI VI KRIMET DHE KUNDRAVAJTJET PYJORE DHE GJYKIMI I TYRE

#### Neni 54

Dëmtimi ose prerja e paligjshme e pyjeve, përvetimi i druve të rena dhe të thyera nga fourtuna ose nga era si dhe çdo shkelje tjetër e dispozitave të vëna për mbrojtjen e pyjeve, kur dëmi i shkaktuar ka një vleftë më të madhe se pesëmijë lekë, sipas tarifës së shpërblimit të dëmeve në pyje, dënohet si krim në bazë të nenit 125 të Kodit penal.

#### Neni 55

Dëmtimi i pyllit me zjarr me dshje ose nga pakujdesia, kur dëmi i shkaktuar ka një vleftë më të madhe se pesëmijë lekë, sipas tarifës së shpërblimit të dëmeve në pyje, dënohet, sipas rastit, në bazë të neneve t85 paragrafi II ose 86 të Kodit Penal.

#### Neni 56

Dëmtimi ose prerja e paligjshme e pyjeve, përvetimi i druve të rënë ose të thyer nga furtuna ose era dhe çdo shkelje tjetër në lidhje me mbrojtjen e pyjeve, kur dëmi i shkaktuar ka një vlef të gjer më pesë mijë lekë, si dhe dëmtimi nga pakujdesia e pyjeve, kur nuk është shkaktuar me zjarr pavarësisht nga vlefja e dëmit të shkaktuar, quhen kundravajtje dhe dënohen me gjoba nga njëqind gjer në pesëmbëdhjetë mijë lekë dhe kurdoherë me marrjen e materialit drusor ose të prodhimeve të tjera pyjore.

Gjithashtu, dënohet si kundravajtje sipas paragrafit të mësipërm, edhe çdo shkelje tjetër e dispozitave mbi pyjet, kur nga këto vepra nuk është shkaktuar dëm.

Nuk përbëjnë kundravajtje shkeljet e kushteve të shfrytëzimit të pyjeve nga ana e shfrytëzuesit, për të cilat në dispozitat e nxjerra nga Qeveria në bazë të nenit 27 të kësaj ligje parashikohen sanksione me gjobë.

#### Neni 57

Kullotja në pyje, në kundërshtim me nenet 33, 34, 35, 36 të kësaj ligje, kur nga kjo nuk është shkaktuar dëm në filiza, llastare, dhe në prodhime të tjera pyjore, dënohet si kundravajtje me gjobë gjer në dhjetë mijë lekë.

Kur nga kullotja është shkaktuar dëm në filiza, llastare dhe në prodhime të tjera pyjore, vepra do të dënohet, sipas rastit, në bazë të neneve 54 ose 56 të kësaj ligje.

#### Neni 58

Transportimi, shitja dhe blerja me qëllim përpunimi për shitje të materialit drusor ose të prodhimeve të tjera pyjore, në kundërshtim me nenin 44 të kësaj ligje, dënohet si kundravajtje me gjobë gjer më dhjetë mijë lekë dhe kurdoherë me marrjen e materialit drusor ose të prodhimeve të tjera pyjore.

#### Neni 59

Vërtetimi i shkeljeve të dispozitave të këtij ligji (krimeve dhe kundravajtjeve bëhet nga personeli i organeve pyjore dhe nga organet e Policisë Popullore.

Procesverbalei nënshkruhet nga përpiluesi, shkelësi dhe nga dëshmitarët, në rast se ka patur të tillë.

Kur shkelësi nuk pranon të nënshkruajë procesverbalin, kjo shënohet në procesverbalin në prani të dëshmitarëve, në rast se ka patur të tillë.

Kur nuk zbulohet shkelësi, kjo shënohet në procesverbal.

#### Neni 60

Personeli i organeve pyjore ka të drejtë të kontrollojë oborret, stallat etj., kur ka dyshime të bazuara se në to mbahet material drusor dhe prodhime të tjera pyjore të nxjerrë nga pyjet në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji. Kontrolli bëhet në prani të një përfaqësuesi të këshillit popullor ose, kur vendi i kontrolluar ndodhet jashtë fshatit, në prani të një dëshmitari.

#### Neni 61

Gjykimi i shkeljeve të dispozitave të këtij ligji, që parashikojnë kundërvajtje, bëhet nga Zyra e pyjeve të vendit ku është kryer kundravajtja brenda dhjetë ditëve nga vërtetimi i saj.

#### Neni 62

Kundër vendimit të dhënë nga Zyra e pyjeve mund të bëhet ankim në drejtorinë përkatëse të pyjeve, brenda dhjetë ditëve nga data e dhënies së vendimit, kur ky është dhënë në prani të shkelësit, ose e komunikimit të vendimit, kur është dhënë në mungesë ose protestë nga prokurori brenda dhjetë ditëve nga dhënia e vendit,

#### Neni 63

Kur nga shkelja e dispozitave të këtij ligji shkaktohet një dëm që ka një vleftë jo më të madhe se dyqind lekë sipas tarifës së shpërblimit të dëmeve në pyje, personeli i organeve pyjore ose prganet e Policisë popullore kanë të drejtë të gjobitin në vend shkelësin me një gjobë baras me vleftën e dëmit të shkaktuar.

Organet e lartpërmendur kanë, gjithashtu, të drejtën të gjobitin në vend me njëqind lekë gjobë cdo person që për herën e parë zihet duke hedhur në pyje cigare të ndezur.

Kur shkeësit nuk pranon të paguajë gjobën, cështja i dërgohet Zyrës së pyjeve e cila ka të drejtë ta shtojë gjobën gjer në trefishin e gjobës së dhënë sipas paragrafit të dytë të këtij neni.

#### Neni 64

Vendimet e dhëna për kundravajtje me të marrë formën e prerë, ekzekutohen nga Zyrat e pyjeve sipas dispozitave mbi kundravajtjet.

#### Neni 65

Gjobat e nxjerra nga ekzekutimi i vendimeve kalojnë 50% në të ardhurat e buxhetit të shtetit dhe 50% në dobi të Drejtorisë së pyjeve, në territorin e së cilës është kryer krimi ose kundravajtja.

#### Neni 66

Shpërblimi i dëmit të shkaktuar nga shkelja e dispozitave të këtij ligji, kur dëmi kalon pesëmijë lekë, sipas tarifës së shpërblimit të dëmeve në pyje, shqyrtohet nga gjykata dhe, kur dëmi është gjer në pesëmijë lekë, nga organet pyjore, në territorin e të cilëve është kryer shkelja.

Kur vepra përbën krim, shpërblimi i dëmit të shkaktuar shqyrtohet nga gjykata, pa qenë nevoja që të paraqitet kërkesë e veçantë.

#### Neni 67

Vendimi përfundimtar, penal ose civil, që përmban detyrimin e shpërblimit të dëmeve të kryera në pyll, kur merr formën e prerë, vihet në ekzekutim nga përmbartuesi gjyqësor me shpejtësinë më të madhe.

#### Neni 68

Ndërmarrjet e shfrytëzimit të pyjeve si dhe kooperativat bujqësore përgjigjen materialisht kurdoherë për dëmet e shkaktuara në pyje me faj nga nëpunësit dhe punëtorët e tyre ose nga anëtarët e kooperativave bujqësore në kryerjen e shërbimit të tyre, në lidhje me shfrytëzimin e pyjeve.

#### Neni 69

Vendimi i dënimit me gjobë, i dhënë nga organet pyjore, nuk mund të ekzekutohet kur ka kaluar një vit nga dita që vendimi ka marrë formën e prerë.

Vendimi për zhdëmtimin e dëmit, i dhënë nga organetpyjore ose nga gjykata, nuk mund të ekzekutohet kur nga data që vendimi ka marrë formë të prerë ka kaluar afati i caktuar për ekzekutimin e vendimeve civile.

#### Neni 70

Personeli i organeve pyjore që shpërdoron pozitpn zyrtare ose mban qëndrim të pakujdesshëm në përmbushjen e detyrave të tij në lidhje me mbrojtjen dhe shfrytëzimin e pyjeve merret në përgjegjësi sipas Kodit penal.

#### Neni 71

Kur çështjet penale pyjore, që ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të ndodhen të varura përpara gjykatës, përbëjnë sipas këtij ligji kontravajtje, gjykata do të vendosë pushimin e gjykimit dhe do t'i dërgojë çështjen organit pyjor kompetent për gjykimin e kontravajtjes; organi pyjor, në këtë rast, nuk mund të japë dënim me gjobë më të madhe se atë që parashikonte Kodi penal në kohën e kryerjes së veprës.

Kur çështjet pyjore që ndodhen në varura përpara seksionit të bujqësisë pranë Komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit përbëjnë kundravajtja edhe sipas këtij ligji, seksioni i bujqësisë do ta dërgojë këto çështje organeve pyjore kompetente për gjykimin e tyre sipas kësaj ligje; organet pyjore në këtë rast do të zbatojnë disëpozitat ligjore të mëparshme ose të këtij ligji, në rast se këto të fundit janë më të favorshme.

### KAPITULLI VII DISPOZITA TË FUNDIT

#### Neni 72

Autorizohet Ministria e bujqësisë për të nxjerrë urdhëra dhe udhëzime për zbatimin e këtij ligji.

#### Neni 73

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet dekreti nr.1482 datë 12.6.1952 “Mbi pyje” sic është ndryshuar me dekretin nr.1628 datë 19.2.1953 si dhe me dekretin nr.2113 datë 8.8.1955.

#### Neni 74

Ky ligj hyn në fuqi më 1 nëntor 1961.

KRYETARI I PRESIDIVMIT TË KUVENDIT POPULLOR  
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISJ  
**Haxhi Lleshi**

SEKRETAR I PRESIDIUMIT TË KUVENDIT POPULLOR  
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË  
**Sami Baholli**